REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

***KOMUNA KLINE***

**ZYRA E PROKURIMIT**

01 nr 312 – 16625/21

Date 31.05.2021

# *KONTRATA PUBLIKE nr. 33/2021*

**PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE**

**KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; Nr Bisnesi 07000032, Nr Fiskal 600219366 , qe perfaqesohet nga Menaxheri i Prokurimit z. Abaz Foniqi

Dhe

SHALA BUILDING SHPK ,Nga Ujmir -Klina, Nr. Biznesi numer Fiskal 810180844 , qe perfaqesohet nga pronari z. VETON SHALA

ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për PUNET në vijim:

**PUNE NE RREGULLIMIN E TREGUT TE GJEKBERT NE KLINE**

me numër identifikues: 634-21-1076-236

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e PUNEVE në vijim:

## 1.2 PARAMASA DHE CMIMET .

| Nr. | Titulli | Çmimi për njësi | Norma e TVSH-së | Çmimi për njësi (me TVSh) | Sasia | Njësia matëse | Totali | Totali (me TVSh) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Pastrimi i terrenit nga shkurret dhe inertet, gërmimi dhe rrafshimi si dhe përgatitja e terrenit. Si dhe në çmim përfshihet hedhja materialit në deponi të caktuar nga organi mbikëqyrës. | 0.20 | 18.00 | 0.24 | 650.00 | m2 | 130.00 | 153.40 |
| 2 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja e materialeve gurore te përziera për nivelimin e shtresës së poshtme – fraksion 0-31 dhe 0-60 mm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25 t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardeve në fuqi për këtë lloj pune (Mt 800 kg cm2). | 5.10 | 18.00 | 6.02 | 165.00 | m3 | 841.50 | 992.97 |
| 3 | Furnizimi, transporti dhe shtrirja montimi i kubëzave te betonit me trashësi 8cm, duke përfshire edhe shtruarjen e shtresës se rërës 5cm për nivelimin e kubëzave, si dhe shtresës se rërës për mbushje te fugave, përpunimi dhe ngjeshja përfundimtare sipas normave dhe standardeve ne fuqi për këtë lloj pune. Niveli i hapësirës se punuar me kubëza te reja nuk duhet te jete i ngritur me shume se 5cm nga niveli i trotuarit ekzistues. Kubëzat duhet te jene me dimensione 30X30cm. Zgjedhja e formës dhe dizajnit te kubëzave behët nga investitori. | 8.00 | 18.00 | 9.44 | 550.00 | m2 | 4,400.00 | 5,192.00 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Furnizimi dhe transporti i skajoreve për kufizimin e kubëzave në pjesën përgjatë oborrit te Shkollës Fillore "Motrat Qiriazi". Vendosja e skajoreve te behet ne shtresën e betonit, ne pjesën anësore për shtangimin e tyre | 3.50 | 18.00 | 4.13 | 120.00 | m | 420.00 | 495.60 |

**1.3. Vlera Totale e Kontrates me TVSH dhe taksa tjera eshte 6.833.97€ Gjashemijeteteqindetridhjetetreeuroee 97/100)**

**Neni 2 Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë i perditeshem sipas përshkrimit te detyrave nga neni 1 i këshaj kontrate eshte **10 dite KALENDARIK** .

2.2 Vendi i kryerjes së puneve sipas Projektit tregu i ri i Gjelbert ne .Kline :

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të puneve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 1.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kryesit te punimeve sipas kontratës publike.

3.3 Çmimet e njësive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike .

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

3.5.Dhe ate me fature dhe Raport mbi kryerje te puneve , Jo me larg se 30 dite pas pranimit te fatures dhe Raportit .

**Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

**4.3. Pagesat do te ekzekutohen me keste sipas dinamike se kryerjeve te punimeve**

**Pagesat do te behen sipas situacineve mbi kryerje te punimeve me Raport nga Komisioni dhe Fatura.Jo me teper se 30 dite pas pranimit te fatures dhe Raportit .**

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

**Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i *puneve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

6.2. Kryesi i puneve do te jete pergjegjes per Demtimet te shkaktuara me dashje apo pa kujdesi ne masen e demit qe do te percaktohet nga zyrtari pergjegjes .

**Neni 7 Vonesat në ekzekutim**

7.1 Ne raste deshtimit apo voneses ne Implementim , Do te penalizohet me masen 0.25% ne dite vonese nga vlera totale e kontrates.

**Neni 8 Inspektimi dhe testimi**

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here tëinspektojë, kontrollojë, dhe te shikoj furnizimet e bera nese eshte ne masen e cilesive te kerkuara .

**Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) la jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

10.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 5 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.